

INSTRUMENTI HORIZONTAL PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQINË 2019-2022

*PËR TË DREJTAT TUAJA:
DREJT STANDARDEVE
EVROPIANE*



Garantimin e drejtësisë

Luftën kundër krimit ekonomik

Luftën kundër diskriminimit dhe mbrojtjen e
të drejtave të grupeve të cenueshme

Lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias

Mekanizmi i Koordinimit të Ekspertizës

<http://horizontal-facility-eu.coe.int>

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



THELLIMI I PËRPEKJEVE ME PRIORITETE TË ZGJERUARA

— “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022” është një iniciativë e përbashkët e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës që i mundëson Përfituesve të përmbushin agjendën e reformave në fushën e të drejtave të njeriut, shtetit ligjor, demokracisë si dhe të respektojnë standardet evropiane, duke përfshirë kur është e mundur kornizën e proceseve të zgjerimit të BE-së. Ai mbështetet te rezultatet dhe progresi i arritur në fazën e parë të programit, zbatuar në periudhën 2016-2019, të cilat përfshijnë:

- ▶ Përparimet në zbatimin e reformave të gjyqësorit, burgjeve dhe policisë përmes mbështetjes teknike ofruar Përfituesve;
- ▶ Harmonizimin më të mirë të legjislacionit dhe praktikave me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj);

Harmonizimi i mëtejshëm i politikave, institucioneve dhe praktikave me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNj), me rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Trajtimit dhe Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues (KPT), si dhe me opinionet e Komisionit të Venecias dhe standardet e Komisionit Evropian për Efiçencën e Drejtësisë (CEPEJ).

- ▶ Forcimin e politikave kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në vendet Përfituese;

Adresimi i mangësive të identifikuara në vlerësimet e Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) dhe Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO).

- ▶ Forcimin e legjislacionit/politikave dhe kapaciteteve për gjithëpërfshirje dhe integritet në arsim, anti-diskriminim, mbrojtjen e pakicave dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore;

Zbatimi i rekomandimeve të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), Grupit të Ekspertëve kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA) dhe Komisionerit për të Drejtat e Njeriut, si dhe atyre që rrjedhin nga monitorimi i Konventës Kuadër për Pakicat Kombëtare (KKPK) dhe Statuti Evropian për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave (ECRML).

- ▶ Udhëzimet ofruar Përfituesve për hartimin e legjislacioneve dhe politikave, përmes Mekanizmit të Koordinimit të Ekspertizës. Për shembull, Ekspertizë e ofruar për Ligjin për Trajtimin e Pronave (Shqipëri); Ligjin për të drejtat e viktimave të torturës (Bosnje dhe Hercegovinë); Ligjin për të Huajt lidhur me migrimin (Mali i Zi); Ligjin për mbrojtjen kundër diskriminimit (Maqedonia e Veriut); dhe dispozitat Kushtetuese në lidhje me gjyqësorin (Serbi).

INSTRUMENTI HORIZONTAL II - NJË VËSHTRIM I SHPEJTË

Shtrirja gjeografike e fazës së dytë të programit mbulon projekte në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë*, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Turqi, me një dimension të qartë rajonal.

Temat e mbuluara nga Instrumenti Horizontal përfshijnë:

- Garantimin e drejtësisë;
- Luftën kundër krimit ekonomik;
- Luftën kundër diskriminimit dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve të cenueshme (duke përfshirë LGBTI, pakicat dhe romët) dhe;
- Lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias..

Buxheti i akorduar për këtë program llogaritet afërsisht në 41 milion euro (85% financuar nga Bashkimi Evropian, 15% nga Këshilli i Evropës)

* Ky përcaktim nuk përbën asnjë paragjykim për qëndrimin mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe me Opinionin e GjND-së për Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.

Struktura e Programit të Instrumentit Horizontal, siç u konsolidua në fazën e parë të programit, ndjek një qasje dy dimensionale:

- Bashkëpunim teknik në formën e ngritjes së kapaciteteve, këshillimit dhe formave të tjera të mbështetjes teknike përshtatur sipas nevojave të secilit vend Përfitues të Instrumentit Horizontal, për të arritur përmbushje më të plotë të standardeve evropiane;
- Mekanizmi për Koordinimin e Ekspertizës, një instrument fleksibël, përmes të cilit Këshilli i Evropës ofron ekspertizë legjislativë *ad hoc* dhe këshillim në nivel politikash në përgjigje të kërkesave të drejtuara nga Përfituesit. Këto kërkesa mund të adresojnë një prej katër fushave tematike të programit, por gjithashtu mund të kenë të bëjnë me çështje të tjera që përfshihen në mandatin e Komisionit të Venecias.



ÇFARË SYNON TË ARRIJË PROGRAMI?

Programi u jep mundësi Përfituesve të realizojnë programet e tyre të reformave në përputhje me standardet evropiane, duke përfshirë sipas rastit, kuadrin e proceseve të zgjerimit të BE-së. Për përmirësimin e mëtejshëm të kuadrin ligjor dhe politikave të ndryshme për përmirësimin e kapaciteteve institucionale, ofrohet mbështetja e përshtatur sipas nevojave dhe e bazuar tek kërkesat e Përfituesve, duke përforcuar funksionimin e institucioneve.

Për këtë qëllim, aktivitetet e programit përfshijnë zhvillimin e kapaciteteve, ofrimin e mbështetjes teknike dhe ekspertizës, si dhe ndërgjegjësimin në të katërta fushat tematike.


Faza e dytë e programit synon forcimin e qëndrueshmërisë së rezultateve të arritura gjatë fazës së parë, duke u garantuar në të njëjtën kohë autorësinë institucioneve Përfituese.

Programi synon të sjellë përmirësime thelbësore drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve përmes projekteve të parashikuara, duke zgjeruar komunikimin në lidhje me rezultatet e prekshme të arritura.

Qasje unike

- ▶ **Projektet e përshtatura** janë projektuar në mënyrë të tillë që të adresojnë nevojat specifike në secilin vend Përfitues, pas konsultimeve me autoritetet përkatëse.
- ▶ **Fleksibiliteti** i Instrumentit Horizontal vlerësohet jashtëzakonisht shumë nga institucionet Përfituese, pasi ai krijon mundësi për përshtatjen e programit sipas ndryshimeve të rrethanave dhe përparësive vendase, duke nxitur një autorësi të fortë lokale të rezultateve. Gjatë zbatimit, burimet mund të rishpërndahen në përgjigje të nevojave që mund të lindin.
- ▶ **Dimensionin Rajonal** është prezantuar në rrjedhën e zbatimit të fazës së parë të programit. Dimensionin edhe më i madh rajonal që spikat në fazën e dytë krijon mundësi për shkëmbime ndërkufitare në adresimin e sfidave të përbashkëta, shkëmbimin e praktikave më të mira dhe krijimin e platformave dhe rrjeteve për këtë qëllim.

- ▶ **Çështjet gjithëpërfshirëse** janë integruar në projekte. Të gjitha aktivitetet në kuadrin e Instrumentit Horizontal II zhvillohen me një qasje të bazuar tek të drejtat e njeriut, duke përfshirë parimet e barazisë gjinore – në përputhje me Strategjinë e Barazisë Gjinore të Këshillit të Evropës dhe bazuar në paketën e integritimit Gjinor për projektet e bashkëpunimit – si dhe tek mosdiskriminimi, barazia dhe pjesëmarrja gjithëpërfshirëse, duke u fokusuar tek grupet e cënueshme dhe pakicat. Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile garantohet në përputhje me Udhëzimet e Këshillit të Evropës për pjesëmarrjen e Organizatave të Shoqërisë Civile në aktivitetet Bashkëpunuese të Këshillit të Evropës dhe në përputhje me Udhëzimet e Komisionit Evropian për mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile në vendet e zgjerimit.
- ▶ **Metodë pune unike përmes trekëndëshit strategjik të Këshillit të Evropës**



Programet e asistencës teknike të Këshillit të Evropës janë pjesë e pandashme e trekëndëshit strategjik unik të vendosjes së standardeve, monitorimit dhe bashkëpunimit: zhvillimi i standardeve ligjërisht të detyrueshme është i lidhur me monitorimin e tyre nga mekanizmat e pavarur dhe plotësohet me bashkëpunimin teknik për lehtësimin e zbatimit të tyre. Projektet e Këshillit të Evropës zhvillohen dhe zbatohen në fushat ku Këshilli i Evropës ka ekspertizë të fortë dhe vlerë të shtuar.

PËR MË SHUMË INFORMACION

<http://horizontal-facility-eu.coe.int>

 [jp.horizontal.facility](https://www.facebook.com/jp.horizontal.facility)

 [@CoE_EU_HF](https://twitter.com/CoE_EU_HF)

KONTAKT

Horizontal Facility Co-ordination Team
Office of the Directorate General of Programmes
Council of Europe
Avenue de l'Europe F-67075 Strasbourg Cedex, France
E-mail: Horizontal.Facility@coe.int

"Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022" është një iniciativë e përbashkët e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës që i mundëson Përfituesve të përmbushin agjendën e reformave në fushën e të drejtave të njeriut, shtetit ligjor, demokracisë si dhe të respektojnë standardet evropiane, duke përfshirë kur është e mundur kornizën e proceseve të zgjerimit të BE-së. Ky program 3-vjeçar mbulon projekte në Shqipëri, Bosnje-Herzegovinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi, Turqi dhe Kosovë*, si dhe zbatohet nga Këshilli i Evropës që prej muajit Maj 2019.

** Ky përkufizim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244/1999 dhe Opinionin e GjND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.*

PREIMS 175719 – Photos: Shutterstock

SQI

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t'i ndajë arritet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të saj.

www.europa.eu

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës